



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 200 Prot.

Tiranë, më datë 04 . 04 . 2025

VENDIM

Nr. 221, datë 04.04.2025

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhërit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 04.04.2025:

VENDOSI

1. Miratimin e Raportit të vlerësimit të potencialit arkeologjik hartuar në kuadër të projektit “Rikonstruktion i objektit ekzistues 1-4 kate dhe unifikim i tij në lartësi 4 kate+ngritje 1 kat mbi të+shtesë balllore 5 kate+bodrum, me funksion hotel+vendosje pergolate”, dhe “Objekt 8 kate+bodrum, me funksion banim+njësi shërbimi+parking”, Brenda Kufirit Zonë e Mbrojtur e Qendrës Historike dhe Zonën Arkeologjike “B” të qytetit të Elbasanit, me aplikues Z. Ergys Çaushti dhe zhvillues subjekti Ndërtim - Montim “Dashi” sh.p.k.;
2. Investitori duhet të lidhë akt-marrëveshje 3 palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili do të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve për projektin “Rikonstruktion i objektit ekzistues 1-4 kate dhe unifikim i tij në lartësi 4 kate+ngritje 1 kat mbi të+shtesë balllore 5 kate+bodrum, me funksion hotel+vendosje pergolate”, dhe “Objekt 8 kate+bodrum, me funksion banim+njësi shërbimi+parking”, në Zonën e Mbrojtur të Qendrës Historike dhe Zonën Arkeologjike “B” të qytetit të Elbasanit, me aplikues Z. Ergys Çaushti dhe zhvillues subjekti Ndërtim - Montim “Dashi” sh.p.k. si dhe Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, i cili do të mbikëqyrë këtë subjekt në bashkëpunim me DRTK Korçë, e më pas subjekti aplikues mund të vijojë me procedurën ligjore për miratimin sipas legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit;
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
4. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR

Joli MITROJORGJI

KRYETAR

Blendi GONXHJA

